

---

**REFERATE E KUMTESA**

---

**BUJAR DUGOLLI**  
**SELIM BEZERAJ**

**DISA TË DHËNA PËR FILLIMIN DHE ZHVILLIMIN  
E KRYENGRITJES SË VITIT 1910  
NË KOSOVËN VERIPERËNDIMORE**

Gjatë vitit 1909, nga liderët shqiptarë, ishte artikuluar më mirë se kurrë më parë, ideja e autonomisë së Shqipërisë. Në këtë drejtim, ideja e autonomisë duhej të shtrohej hapur edhe në popull. Lidhur me këtë, si faktorë që e vështirësuan mundësinë e mobilizimit të popullit shqiptar për rezistencë evidencojmë mungesën e organizimit politik. Gjithashtu nuk kishte mundësi që përmes shtypit të kohës të informohej dhe vetëdijesohej populli në rrafshin patriotik kombëtar, pasi shqiptarët në masë të madhe nuk dinin as shkrim e këndim.

Për shqiptarët, në këtë kohë shtroheshin disa nevoja imediate për të nisur kryengritjen. Duhej të luftonin kundër pushtetit osman, kundër propagandës serbe që nxiste shqiptarët të armiqësoheshin me të gjithë dhe kundër agjentëve shqiptarë, që i shërbenin pushtuesve. Në këtë mozaik të luftës, mundësitë e mobilizimit për kryengritje, ishin: ftesa që populli t'i rezistonte mbledhjes së taksave, të mos t'i dorëzonte armët, që pushtuesit të ndalnin bombardimin dhe rrënimin e kullave, si dhe të investonin në ndërtimin e atyre që i kishin shkatërruar. Në këto rrethana, shqiptarët do të përpiqeshin që dhunës osmane dhe serbe t'u jepnin një goditje në tri pika strategjike. Së pari, lufta kundër osmanëve ishte paraparë të zhvillohej si një luftë pozicionale në Kulinë, në veri të Prishtinës, pasi ishte nyje strategjike që lidh Rrafshin e Kosovës me trevën e Llapit. Së dyti, kryengritja, duhej të përhapej në Kaçanik, duke e ndërprerë lidhjen e forcave osmane që gjendeshin në Kosovë me ato që gjendeshin jashtë saj. Së fundi, ishte planifikuar që t'i jepej grushti vendimtar pushtetit osman në Kosovë, në Ngushticën e Carralevës.

Gjatë verës së vitit 1909, repartet të mëdha osmane, prej pesë batalionesh, të gjitha të specializuara për të kryer luftë speciale në popull, të përforcuara edhe me topa për të shkaktuar frikë në masë, për të rrënuar

kullat prej guri, u hodhën kundër shqiptarëve të Kosovës. Ato i komandonte Xhavit Pasha, i cili kishte të gjitha autorizimet për të përdorur dhunë të çdo lloji. Së pari ky oficer osman filloi ta “qetësojë” popullsinë e Dukagjinit, duke menduar se kryengritja e kishte komandën atje. Në fakt kishte ngjarë e kundërta. Qendra e kryengritjes tani po përgatitej të shndërrohej në malet e Shalës së Bajgores, ku ishte Isa Boletini.

Në fund të nëntorit të vitit 1909, Isa Boletini mbajti disa tubime në popull në rrethinën e Vushtrisë, pastaj në Kulinë, për t’u përqendruar, së bashku me Ahmet Delinë në Drenicë. Pasi mori mbështetjen për rezistencë, tubimin e fundit e mbajti në kullën e Sylë Hysit, në Popovë. Aty u caktua që të mobilizoheshin forcat kryengritëse nga Drenica, Shala dhe Llapi. Si pikë takimi për kuvendin që do të organizohej u caktua kulla e Sylë Hysit–Popovës, për këtë ishte njoftuar edhe Komiteti Shqiptar me qendër në Ferizaj. Në tubimin që u mbajt më 26 nëntor 1909, në kullën e Sylë Hysit, morën pjesë 30 delegatë, 10 nga Drenica, 10 nga Shala e 10 nga Llapi. Isë Boletini konsiderohej si kryetar i kuvendit dhe u deklarua si anëtar i 31-të i “Besës Shqiptare për kryengritje”.

Sipas Tafil Boletinit, nga fundi i vitit 1909, në Shalë të Bajgores kishte ardhur, nga Stambolli, Zeqir Breca, një tregtar i njohur, që ishte njëheri edhe mik shtëpie i Isa Boletinit. Isa Boletini e kishte takuar në familjen e Muratit në fshatin Banjë. Aty, sipas Tafil Boletinit: “Ismail Qemal begu i shkruante Isa Boletinit se “i dhimbsej që ishte dëmtuar shumë në luftën që kishin bërë turqit kundër tij”. Zeqir Breca, gjithashtu, kishte sjellë një letër nga Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina, në të cilën paraqitej programi i kryengritjes për vitin 1910. Në bazë të kësaj kërkesë programatike, të ardhur nga Stambolli, Isa Boletini menjëherë do të niste aktivitetin e tij patriotik, duke u lidhur, në rend të parë, përmes Isniqit, me Sylejman Batushen e Gjakovës, pastaj duke krijuar lidhje të fuqishme gjithëshqiptare, në një lidhje BESE te Verrat e Llukës, e për të vazhduar kështu duke siguruar përkrahjen e Abdullah Çupit të Drenicës, në Klinë, përkrahjen e parisë së Llapit, si të Haxhi Sadrisë, Islam Ukë Bulliqit, Shaban Binakut, Shaban Kapuçit të Vushtrisë e shumë trimave të tjerë. Pas këtyre kuvendimeve në terren, u mbledh Kuvendi i Popovës në kryesinë e Isa Boletinit. Tridhjetënjë delegatët nga Drenica, Shala dhe Llapi, më 25 dhjetor 1909 morën këto vendime:

“1. Në pranverë të vitit që vjen, pa ra dushku prej rremit, të ngrihemi në kryengritje në tri pikat kulmore strategjike shqiptare në Kulinë, në Kaçanik dhe në Carralevë;

2. Pas kryengritjes, në këto tri pika të zgjerohet lidhja kryengritëse me Besa-Besë edhe në Malësinë e Shkodrës;

3. Pas kryengritjes të ndërtohet një administratë ushtarake derisa të ndalohen sulmet turke;

4. Të fillohet me hapjen e shkollave me Alfabet të Manastirit, por në shkolla të mësohet edhe këndimi i Kur’anit;

5. Të ndërtohen rrugë dhe ura me ndihmën e fuqisë punëtore nga populli;

6. Të formohet një komitet bujqësor, i cili do të kryente dy funksione - bereqeti të kultivohet me kujdesin më të madh, ndërsa gjëja e gjallë (bagëtitë dhe shpezët) të ushqehen mirë e të përdoret ushqim me bollëk për tërë miletin (popullin);

7. Uji i krojeve dhe puseve në kohën e luftës të ruhet në mënyrë që armiku të mos e helmonte me ndonjë kufomë apo me diçka tjetër si hedhurina e mbeturina të bagëtitë të ngordhura;

9. Shëndeti i popullit të ruhet duke përdorur ushqim të bollshëm dhe të përgatitur mirë;

10. Rrugët e hekurit dhe xhadet e Evropës (rrugët e Evropës – B.D.) të bllokohen në mënyrë që armiku mos të mundet me u vendosë në brendi të Kosovës”.

Hovin kryengritës do ta nxisin sjelljet e pushtetit ndaj klubeve shqiptare, kundërshtimet e disa ulemave të Prishtinës ndaj Alfabetit të Manastirit, që në këtë mënyrë e kishin acaruar situatën tej mase. Në fillim të shkurtit të vitit 1910 xhonturqit urdhëruan që të gjitha shkollat në vilajetin e Kosovës mund të funksiononin vetëm nëse i adresoheshin alfabetit kuranor. Të gjithë arsimtarët që kishin aplikuar sadopak në shkallë të ulët “alfabetin e kaurëve”, pra Alfabetin e Manastirit, ishin kërcënuar se do të pushoheshin nga puna.

Ky qëndrim ishte kulmi i kundërthënies dhe pritej që të fillonte kryengritja, të cilën shqiptarët ishin të interesuar ta zhvillonin deri sa malet e Kosovës “të jenë të gjelbëruara, dhe më së largu kur pylli të ishte me gjethe të vyshkura”. Kjo përplasje politike synohej të zgjaste deri në fillim të shtatorit. Kështu, në Kosovë, krahas zhvillimeve të tjera po rritej në shkallë të madhe interesimi edhe për Alfabetin e Manastirit. Kërkesat për alfabetin me shkronja latine të Kongresit të Manastirit dhe çështjet e

tjera të karakterit kombëtar shqiptar e rrëzonin tezën se kryengritja kishte karakter ekonomik kundër taksave, e jo karakter kombëtar. Lidhur me këtë çështje raportet konsullore serbe i japin një konotacion tjetër kryengritjes dhe karakterit të saj. Sipas tyre, kryengritësit kërkonin nga qeveria vetëm neutralitet. Nëse kjo nuk do të ndodhte, si fillim populli do ta shprehte qëndrimin e vet me një demonstratë antiqeveritare.

Dita e fillimit të kryengritjes u ishte lënë në kompetencë për ta caktuar vetëm një rrethi të ngushtë: Isa Boletini, Haxhi Sadria, Sylë Popova, Ahmet Delia dhe një oficer nga Vushtria, i cili mund të ketë qenë Shaban Kapuçi, siç shprehet Sylë Hys Popova në kujtimet e tij. Deri në fillim të marsit 1910, Isa Boletini kuvendoi edhe dy herë në Popovë me udhëheqjen e tri nahijeve kryengritëse shqiptare: Drenicës, Shalës së Bajgores dhe Llapit përfshirë Gallapin. Në këto bisedime u shqyrtua data e fillimit të kryengritjes, çështja e armatimit, çështja e ushqimit, çështja e të plagosurve dhe çështja e lidhjeve me fuqitë e tjera në vend. U rekomandua që me serbët të mos kontaktohej, përderisa të mësohej fundi i luftës shqiptare në të tri vendluftimet: Kulinë, Kaçanik dhe Carralevë.

Më 21 mars 1910, në kullën e Sylë Hys Popovës, për herë të fundit, do të kuvendonin para fillimit të kryengritjes Isa Boletini, Ahmet Delia, përfaqësues i Drenicës, Bajram Selaci, përfaqësues i Shalës dhe Haxhi Sadrija, përfaqësues i Llapit, kuptohet, në prani të delegatëve të tri nahijeve kryengritëse. Punimet e kuvendit i drejtoi Isa Boletini. Në kuvend Isa Boletini i njoftoi kryetarët e delegacioneve se për fillimin e kryengritjes ishte marrë edhe mendimi i Hasan Prishtinës dhe Nexhip Dragës, të cilët cilësoheshin si përfaqësues të Kosovës në Parlamentin Osman.

Zëvendëskonsulli serb në Prishtinë, Milan Rakići, i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Serbe, nga Prishtina, më 7 mars 1910, se serbët nuk kishin mundësi të rekrutoheshin në ushtrinë turke, “sepse çdo gjë këtejpari është në çrregullim e sipër, sepse shqiptarët janë në prag të kryengritjes”. Lidhur me këtë, në raportet konsullore theksohet se rekrutimi është zgjatur për aq kohë sa të kuptohen qëllimet e shqiptarëve në përgjithësi.

Kryengritja shqiptare, më 1910, u zhvillua me një dualizëm të theksuar: për sulltan Abdyl Hamitin (që sundoi gjatë viteve 1876-1909) dhe kundër tij, pasi më 27 prill 1909, xhonturqit e kishin rrëzuar nga froni Sulltan Abdyl Hamitin dhe në pushtet sollën Mahmut Reshatin V.

Sipas burimeve konsullore, shqiptarët në Drenicë, Shalë dhe Llap, nuk i drejtoheshin më pushtetit për çka donin, por vetëm për çka nuk donin. Në këto raporte thuhet se në tërë Drenicën, askush, nuk paguan taksa dhe nuk i përgjigjet ftesës për rekrutim. Komisionet mjekësore të rekrutimit, as nuk kishin guxuar të lajmëroheshin. Madje, sipas konsullit serb, “shqiptarët e kazasë së Vushtrisë, ku bënte pjesë administrative edhe Drenica, Shalësi dhe Llapi, gjatë marsit dhe prillit nuk donin as të bisedonin me kajmekamin, çdo fjalë e tij ishte e pavlerë, sepse pushteti i kishte torturuar shumë keq këta banorë. Në tërë këtë territor, kishte raste kur shkonte si ushtar bedel (zëvendës), ai që me përkatësi ishte jevg”.

Në lidhje me zhvillimin e kryengritjes shqiptare në veri të Prishtinës, pikërisht në Kulinë, ku ishin tubuar të gjithë kreshnikët e Llapit, Shalës dhe Drenicës, zëvendëskonsulli serb Milan Rakići, nga Prishtina më 4 prill 1910 shkruante: “Në këtë çast filloi lufta në Llap (në Kulinë). Atje po marrin pjesë dy batalione të këmbësorisë turke. Krisma e armëve po ndihet edhe në Prishtinë”. Po në këtë ditë, në dokumentet konsullore pohohet: “Lufta po vazhdon tani për katër orë. Lufta po zhvillohet në kufirin e Luginës së Llapit dhe Kosovës, që do të thotë në pikën strategjike në Kulinë. Shqiptarët po mbahen shumë mirë. Nëse ushtria nuk arrin t’i nënshtrojë shqiptarët deri në mbrëmje, pozita e ushtrisë turke në qytetin e Prishtinës, Vushtrisë dhe Mitrovicës, do të bëhet shumë kritike, aq më shumë kur Llapit po i vjen në ndihmë djalëria kreshnike nga Drenica, e njohur për luftë antiturke”. Edhe në raportet telegrafike të shërbimeve konsullore serbe, austro-hungareze dhe ruse thuhej se “pozita e ushtrisë, në mbrëmje, më 4 prill 1910, është shumë kritike. E tërë ushtria turke, në anën tjetër, ka lëvizur nga Prishtina, po edhe nga Shkupi, duke tentuar që t’iu kthehet në ndihmë reparteve turke në front, sepse ato kanë pësuar humbje të mëdha. Është e mundur që shqiptarët ta marrin Prishtinën”.

Në ditarin e Milan Rakićit, më 5 prill 1910, shkruhet: “Nga mëngjesi, në Prishtinë kanë filluar të sillen të plagosurit e parë nga fronti i Kulinës. Në mbrëmje, atje, luftimet kanë qenë shumë të ashpra. Shqiptarët, nga vijat e para të frontit ua kanë grabitur turqve në sulmin e parë të rrufeshëm 6 topa, prej të cilëve ushtria sot ka arritur t’i kthejë në pozicionet e veta 5 topa ku ishin më parë. Por, marrë në përgjithësi, ushtria nuk ka shënuar asnjë përparim. Lufta po zhvillohet tani nga një orë e gjysmë ecje në këmbë, larg Prishtinës”. Në mesin e të njëjtës ditë, konsullatit e huaja lajmëronin se “lufta ka zgjatë tërë natën”. Ndërsa,

ushtria solli përforcime nga Ferizaj. Në vijat e frontit u sollën edhe 4 batalione elitë nga Shkupi. Kjo ushtri ishte përqendruar vetëm që të pengonte hyrjen e shqiptarëve si çlirimtarë në Prishtinë. Pritet hyrja e forcave shtesë të shqiptarëve nga Drenica. Raportet e kohës flasin për frikën që mbretëronte në disa qarqe pro osmane në Prishtinë.

Në mbrëmjen e 5 prillit raportet konsullore për frontin e luftës në Kulinë, shkruanin: “Pozita e ushtrisë është dobësuar seriozisht. Sot, pasdite, reparteve turke u erdhi në ndihmë një kontingjent prej 5 batalionesh, njëri prej të cilëve menjëherë ka hyrë në luftime. Në këto rrethana, një pjesë e shqiptarëve nga Drenica, me rreptësinë më të madhe iu është bashkangjitur llapjanëve në luftë. Ata po i granatojnë me breshëri armësh trupat osmane nga kodrat e Majacit, në anën perëndimore të Kulinës. Ushtria osmane dhe kryengritësit shqiptarë, tani për tani kanë mbetur në pozicionet e vjetra. Fitoren do ta korrë ai që ka më tepër municion dhe aftësi e motive për luftë. Luftimet po vazhdojnë”.

Lidhur me kryengritjen shqiptare që kishte marrë karakter të përgjithshëm në veri dhe perëndim të Kosovës, lajmëronte edhe përfaqësia diplomatike austro-hungareze. Ambasadori austro-hungarez në Stamboll fliste për këtë kryengritje, fronti i së cilës ishte përqendruar në vendin e quajtur Kulinë. Sipas tij, luftimet zhvilloheshin në një territor të gjerë. Ai mendonte se lufta do të shpërthente më vonë edhe në viset e tjera, edhe pse momentalisht ishte përqendruar vetëm për dominimin në grykën strategjike të Kulinës. Palavicini ishte informuar se shqiptarët do t'i vazhdonin luftimet e tyre edhe në Ngushticën e Kaçanikut dhe të Carralevës pasi ata kishin mbi 10 mijë kryengritës, të cilët, siç dukej, kishin edhe municion të mjaftueshëm.

Dokumentet konsullore pohojnë se në veri të Kosovës, ku po zhvilloheshin luftime gjithnjë më të ashpra, shqiptarëve u kishin ardhur luftëtarë nga viset e tjera, mbi 20 mijë veta. Atyre po u prinin: Haxhi Sadria, Ahmet Delia dhe Bajram Selaci.

Diku, në prapavijë, qëndronte duke drejtuar komandën e kryengritjes shqiptare, Isa Boletini. Devizë e këtyre kryengritësve shqiptarë ishte bërë: “Rroftë Abdyl Hamiti, poshtë i mallkuari Sulltan Reshati”. Me këtë vërtetohet se Isa Boletini, po përpiqej që të luftonte për ndërrimin e sulltanëve në fronin e Stambollit. Sipas konsullit serb në Shkup, kryengritja, nuk kishte synim që shqiptarët të themelonin ndonjë qeveri provizore. Për këtë ndryshim eventual, ata, tani për tani, nuk kishin as ide as synime të rastit.

Më 6 prill 1910, kur shqiptarët e Drenicës, me Ahmet Delinë në ballë kishin hyrë në front, qëllimi i kryengritjes kishte ndryshuar paksa, sepse Drenica nuk pajtohej me Isa Boletinin që kryengritja të zhvillohej “pro Abdyl Hamitit” të rrëzuar “dhe kundër” Sulltan Reshatit në pushtet. Drenicasit, sipas kujtimeve të Sylë Hys Popovës, kishin synime krejt të ndryshme: ata donin të zhvillonin luftë: “Për shqiptarë, kundër çdo sulltani”.

Synimi final i tyre ishte që t’i jepnin fund sundimit osman. Por, edhe këta nuk e kishin të qartë se si duhej të çliroheshin përgjithmonë nga ajo peshë robërie. Përqendrimi te kërkesa për të mos dhënë taksa e as rekrutë, në një farë mënyre ishte shndërruar në një qerthull. Përfaqësitë diplomatike, theksonin se këto kryengritje si në veri ashtu edhe në jug të Prishtinës, edhe pse me karakter lokal, po e shndërronin Kosovën në një pjesë të Çështjes Lindore, sepse këto kryengritje po nxirrnin në shesh energji të reja politike, të cilat ngadalë po e formësonin edhe interesin kombëtar të shqiptarëve. Pra, shikuar në aspektin real të veprimit, çështja shqiptare, në këto rrethana, po merrte karakter gjysmëncional, gjysmëpolitik dhe gjysmënshtures ndaj sulltanit. Kjo ishte një pozitë politike prej së cilës shqiptarët ishte vështirë që të shkëputeshin.

Gjatë 6-10 prillit 1910, të dy palët ndërluftuese kishin bërë përpjekje që të ripozionohen në pika strategjike sa më të volitshme. Ushtria turke, për shkak të epërsisë në armatim, kishte arritur që t’i përmirësonte pozitat vetëm në krahun e majtë. Mbi fshatin Barilevë kishte vendosur topat për të goditur shtëpitë. Por, meqë shqiptarët ishin në pozicion shumë më të volitshëm, në majë të Kulinës, nga ai pozicion kishin filluar të hapnin zjarr me top të grabitur mbi të gjitha pozicionet e ushtrisë turke.

Në raportet diplomatike jepeshin informata shqetësuese dhe prognoza pesimiste mbi epilogun e kryengritjes në dëm të osmanëve. Raportet konsullore serbe, me vetëbesim, theksonin se shqiptarët nuk do të luftonin më tej, sepse i kishin plotësuar ambicet e tyre. Ndërsa dokumentet diplomatike austro-hungareze lajmëronin se shqiptarët nuk do ta ndalnin intensitetin e luftës, derisa çështja e tyre të shtrohej seriozisht për zgjidhje. Por se çfarë lufte mund të bënin me ushtrinë osmane kryengritësit shqiptarë, dëshmon edhe ky fakt: për topin e grabitur prej osmanëve, shqiptarët kishin vetëm 5 gjyle municion. Me të mbaruar municioni, ky top do të ishte një mbeturinë, pa asnjë vlerë. Në rast fitoreje, në anën tjetër, ai top mund t’u shërbente shqiptarëve vetëm si kujtesë e fitores historike.

Mund të nënvizojmë disa faktorë që ndikuan në mosesin e kryengritjes në veriperëndim të Kosovës në vitin 1910:

1. Fuqitë e Mëdha, duke respektuar politikën e ruajtjes së status quo-së në gjithë Perandorinë Osmane, nuk e përkrahën kryengritjen shqiptare të Kosovës, duke i trajtuar ngjarjet në Kosovë si një çështje thjesht e brendshme e Perandorisë Osmane dhe i lanë dorë të lirë Stambollit për shtypjen e kryengritjes;

2. Shtetet ballkanike posaçërisht Serbia, nuk e dëshironte fitoren e kryengritjes. Kryeministri serb Nikolla Pashiq shprehu mendimin se, ishte në interesin e Serbisë dhe të vendeve të tjera ballkanike që konflikti i armatosur i shqiptarëve me xhonturqit të ishte sa më i përgjakshëm, në mënyrë që të dyja palët të dobësoheshin sa më shumë. Sipas parashikimeve të tij, kështu do të arrihej qëllimi i dyfishtë: nga njëra anë, dobësimi i Perandorisë Osmane do ta lehtësonte luftën e ardhshme të Serbisë e të Bullgarisë kundër saj; nga ana tjetër, shqiptarët e mposhtur nga ushtria osmane do të arrinin në një gjendje të tillë sa të pranonin të viheshin nën Serbi. Diplomatët serbë ndiqnin me kënaqësi çarmatimin e shqiptarëve nga autoritetet ushtarake osmane. Përfaqësuesi i Beogradit në Stamboll e siguronte ministrin e Jashtëm të Perandorisë Osmane, se Serbia ishte e gatshme t'i bënte Perandorisë Osmane shërbimet e nevojshme për t'ia lehtësuar punën për shuarjen e kryengritjes. Edhe Porta e Lartë e priti me kënaqësi gatishmërinë e Beogradit për të ndihmuar në qetësimin e gjendjes në Kosovë.

3. Në dobësimin e rolit të kryengritjes së vitit 1910 në veriperëndim të Kosovës, ndikoi edhe mungesa e një qendre të vetme drejtuese politike e ushtarake në shkallë kombëtare ose të paktën ndërkrahinore me qëllim të artikulimit të kërkesave për autonomi ose pavarësi. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e vendit qëndroi indiferent ndaj kryengritjes së vitit 1910 dhe nuk u përfshi në luftën e armatosur kundër regjimit xhonturk.

### Burimet dhe literatura

#### Arkivat

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK). Fondet:

- Gazeta "Kosova" (1941-1942), *Kryengritja shqiptare e vitit 1910 në vilajetin e Kosovës* (kujtime të mbledhura nga një autor anonim më 1941);
- Deklaratë e Hys Popovës më 1973 për Kuvendin e Popovës dhe kryengritjen e Kulinës;
- Kujtime të Hys Popovës, 1973;

- Kujtime të Qazim Bajgores, në Mitrovicë, 1974;
- Joca Jovanoviq, 6 shkurt 1910;
- Cfr: Raport i konsullit serb, më 18 mars 1910, material i botuar në “Çinjenice o Kosovu”, 1988;
- Kujtime të Met Podujevës, pjesëmarrës në kryengritjen e Kulinës më 1910, si korrier i Haxhi Sadrisë - deklaratë e lëshuar më 1973.

*Državni Arhiv Sekretarijata Inostranih Poslova, Beograd (DASIP). Fondet:*

- PO, F. 15, 1909 – “Dogadjaji na Kosovo”.
- PO nr. 2092, Raport nga J. Palavićini, ambasador i Austro-Hungarisë në Stamboll, më 6 prill 1910; Raport i J. M. Jovanoviqit, nga Shkupi, më 9 prill 1910;
- PO, F. 15-1910, Raport i konsullit serb nga Shkupi, më 1910. Raport i oficerit turk për shtabin e tij në Shkup, më 9 prill 1910, ku thekson se pozita e ushtrisë turke është përballë një zjarri të rrufeshëm dhe se është rrezik që kryengritësit do të mësyjnë në Prishtinë.
- F. 23, 9.IV.1910, Raport i M. Rakićit, më 7 prill 1910, “Ushtria nuk ka arritur t’i shpartallojë shqiptarët. Nëpër qytetet e Kosovës mbretëron frika”;
- F. 23, 9.IV.1910, Raport i përfaqësuesit austro-hungarez, nga Shkupi, më 8 prill 1910.
- F. 15, 1910, Telegrame nga Prishtina, Shkupi dhe Selaniku për vlimet politike në veriun e Kosovës.

### **Bibliografi**

Rakić, Milan - *Konzulska Pisma (1905-1911)*, Beograd: 1983, f. 45.

